



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : *Rajoni/Lagjja nr. 1*

Data : 14.10.2022

Ora : 13.00

Vendi: *Salla e Këshillit Bashkiak Shkodër.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 35, nga të cilat 13 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Per draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës : *Drejtues dhe specialist të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).*

Takimi bashkë-drejtohet nga *Zv.Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:*

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon:

Hapja konsultimit nga zv. Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

Fillojmë me radhe sipas funksioneve tona duke nisur nga :

1- Arsimi baze dhe parashkollor

Andi Kadija – Shkolla “Ndre Mjeda” , ka një problematikë të madhe në oborrin e shkollës i cili në raste shirash mbushet me ujë dhe krijon problem për të gjithë nxënësit që vijnë në shkollë, është problematike e trashëguar – dhe me sa kemi diskutuar me drejtorin ekonomik të arsimit z. Ivziku ky problem do të shkojë drejt zgjidhjes.

Blerina Kraja – kemi një problematikë për shkollën “Ismail Qemali”, ku hyrja e shkollës dhe dera kryesore me një rreshje shiu krijon shumë problem me hyrjen dhe daljen e nxënësve nga shkolla. Aty është me disnivel dhe duke qënë se shkolla ka një numër të madh nxënësish mësimi zhvillohet edhe pasdite.

Gjatë kohës së pushimeve verore oborri i shkollës frekuentohet nga fëmijë dhe adoleshentë të cilët kanë dëmtuar pjesë të këtyre ambjenteve të jashtme, duhet të ketë vëmendje të shtuar për t’u ruajtur sidomos gjatë verës.

Nen kryetari – Do të kemi vëmendje dhe sa i përket rojeve që janë të angazhuar në këtë shkollë që të kenë kujdes gjatë verës në mënyrë që të ruhen këto ambjente. Do t’i adresojmë të dyja këto problematika që thatë.

Vildana Gushta - Pranë shkollës “Ismail Qemali” duhet të rritet frekuenca e pastrimit sepse ka pikë grumbullimi dhe shpesh ka grumbullim të madh të mbetjeve.

2- Menaxhimi i mbetjeve

Ju lutem të merrni fjalën dhe diskutoni për problematikat e menaxhimit të mbetjeve.

Vildana Gushta – Në momentin që kompania e pastrimit është funksionale dhe kryen detyrat sipas kontratës nuk ka problem.

Blerina Kraja – Një sugjerim për zonat ku ka shumë dëndësi popullsie propozoj që të shtohen kosha mbeturinash sepse nuk mund të perballohet me dy kosha. Në rrugën për tek Ndre Mjeda nga Zdralja. Shpesh banorët hedhin në kosha edhe materiale nga sistemimi i oborreve – bimë apo inerte dhe është problem i ndërgjegjësimit të qytetarëve.

Aty është edhe duke u bërë ndërtim i ri i një pallati dhe duhet studiuar situata për shtim të pikave të grumbullimit.

Zv. kryetari – Kjo është shumë problem për të gjithë sepse asnjë nuk i do koshat pranë mjediseve të tyre, për sa i përket koshave shtesë për pallatet e reja do të identifikojmë së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve Publike një zgjidhje alternative për pikat e grumbullimit.

Vështirësitë janë nga më të ndryshmet sidomos për shërbimin e pastrimit ku banorët hedhin mbetje të cilat nuk pranohen nga landfilli ose shprazen kazanat në tokë nga vetë banorët – kjo kërkon bashkëpunim dhe ndërgjegjësim nga ana e të gjithëve.

Andi Halluni – tek rruga e Shirokës kazanet e plehrave janë përherë të mbushur plot nga bizneset e shtrira në këtë rrugë. Duhet që të ndahen kazanet për lokalet dhe një tjetër për banorët sepse nuk është e drejtë për banorët që të kenë një situatë të ndotur nga mbetjet e restoranteve.

Zv. kryetari – sezoni turistik ka pasur një fluks të lartë turizmit e për rrjedhojë edhe nivel të lartë mbeturinash nga ana e bizneseve – kemi shtuar fluksin por akoma nuk kemi gjetur një bashkëpunim dhe ndërgjegjësim të madh nga ana e bizneseve. Zgjidhje mund të jetë kjo alternative për të diferencuar pikat e grumbullimit të bizneseve dhe familjeve, banorëve.

Vildana Gushta – tek pika e grumbullimit në fund të Xhabijes, në momentin që supermarketet kanë ditët e pastrimit të tyre ato i hedhin në kosha duke zënë të gjithë vendin dhe koshat e mbeturinave.

Zv. kryetari – kemi mbledhur menaxherët e supermarketeve të mëdha për të gjetur një zgjidhje të përbashkët për këtë situatë.

Shkëlzen Kraja – tek zona rreth e rrotull stadiumit është e nevojshme që të shtohen kazana dhe pika grumbullimi.

Zv. kryetari – për sa i përket qytetit për pak ditë ne do të kemi një shtesë të numrit të kazanave të cilët do të shpërndahen.

3- Shërbimet në komunitet ndriçim qjellbërim

Shkëlzen Kraja – për sa i përket ndriçimit dhe infrastruktures rreth e rrotull stadiumit, jemi të detyruar që të ndezim dritat e stadiumit për të ndriçuar pjesën e jashtme të tij.

Zv. kryetari – për pak ditë ne do të bëjmë ndërhyrje restauruese për hapësirën rreth stadiumit.

Banor, Zogaj – ne si komunitet kemi një shqetësim, ka ardhur një firmë dhe po bën punimet tek moloja në Zogaj, por ne gjatë kësaj periudhe kemi sezonin e peshkimit dhe përgjatë kësaj kohe po krijon shumë problem për peshkimin. Duhet të ketë ndërhyrje të bashkisë për këtë situatë.

Sa i përket ndriçimit – shpesh ka problem për energjinë e cila kur mungon na mungon edhe uji.

Zv. kryetari – sa i përket ndërtimit të moleve, është me leje ndërtimi ky investim nga ana e Fondit Shqiptar dhe janë zhvilluar edhe konsultime publike për këtë do të verifikojmë në terren situatën, por investimi duhet të vijojë.

Sa i përket energjisë do të verifikojmë mundësinë e shtimit të ndriçuesve.

4. Gjellbërimi

Andi Kadija: Fundi i unazës perëndimore, tek karburanti Start pranë Bërdicës (bahcallek), Isuf Sokoli ka tre ndricues që mungojnë.

Për gjelbërimin ka shumë problem në unazë për pemët e mëdha që gjatë dimrit dhe erës pemët janë duke shkaktuar edhe dëme.

Zv. kryetari – jemi duke marrë masat me operatorin dhe drejtorinë e shërbimeve për sa i përket sistemit të bimësisë dhe pemëve në rrugën e unazës si dhe në zonën e Rusit. Jemi në përfundim të planit të punës për të ndërhyrë.

5.Rrjeti Rrugor

Minir Loku, Rruga “Isuf Sokoli”- na është premtuar rikualifikimi i bllokut të pallateve në zonën Isuf Sokoli.

Zv. kryetari – Është miratuar fondi në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak dhe brenda këtij viti do të finalizohet edhe prokurimi për të vijuar zbatimin e tyre.

Janë disa rruge nga Rajoni nr.1 që janë vendosur për zbatim me vendimin e fundit të Këshillit Bashkiak.

1. Blloku Isuf sokoli
2. Rruga Kraje
3. Jul Variboba
4. Et’hem kazazi
5. Selim Gjyrezi

Vildana Gushta - Si banore e rajonit nr. 1 paraqes problematikat e dy rrugëve që me vite janë përmendur dhe asnjëherë nuk kanë filluar zbatimin

1. Rruga “Hasan Podgorica”
2. Rruga “Xhemal Naipi”

Janë rrugë shumë problematike dhe të frekuentuara nga shumë banorë.

Andi Kadija – Tek prioritetet që kemi dërguar për 2022 – 2024 janë dërguar 18 rrugë:

Rr. Has Hoxha 17 shtëpi – 50 banorë

Rr. Bletëve 10 shtëpi – 40 banorë

Degëzim Vëllezërit Frashëri 22 shtëpi – 80 banorë

Degëzim Kotrrejt – Vëllezërit Frashëri 25 shtëpi - 100 banorë

Degëzim Shporej – Myzafer Pipa 10 shtëpi – 40 Banorë

Degëzim Kongresi i Manastirit 8 shtëpi – 30 banorë

Rr. Xhemal Naipi 12 shtëpi – 50 banorë

Rr. Hasan Podgorica 20 shtëpi – 80 banorë

Rr. Osja i Falltores 3 pallate, 5 shtëpi – 100 banorë

Rr. Tahir Dizdari 1 pallat 2 shtëpi – 50 banorë

Rr. Çakej Bllok Pallatesh 8 shtëpi, qëndër shëndetsore – 280 banorë

Rr. Elvia Çelebi – pranë kopshtit Beb Tusha 2 pallate 1 kopësht – 250 banorë

Rr. Selim Bushati 50 shtëpi – 200 banorë

Rr. Selim Çoba 40 shtëpi – 160 banorë

Rr. Çun Mula 25 shtëpi – 100 banorë

Rr. Karvanej 20 familje

Zv. kryetari – gjatë këtyre viteve janë realizuar një sërë investimesh dhe shpresojmë që të kemi mundësi të vijojmë me këto investime.

Andi Halluni – rruga Ethem Osmani (pranë prokurorisë) pjesa e trotuareve dhe sistemi i ndriçimit mungojnë – gjithashtu duhet vendosur edhe sinjalistika përkatëse.

Tek rotonda pranë dyqanit mega – ka kangjella që krijojnë problem për kalimin e këmbësorëve.

Zv. kryetari – e dimë që është shumë problem e kemi diskutuar edhe me firmën e zbatimit dhe do vijojmë me përfundimin e punimeve.

Meridian Dervishi – operatori për linjën e transportit publik - Për rrugën Xhabije kemi shumë problem gjatë qarkullimit për shkak të nivelit të lartë të trafikut.

Zv. kryetari - për këtë rrugë jemi drejt fillimit të rrugës së biçikletave për këtë aks që do të krijojë lehtësi edhe për transportin publik. Modeli i korsisë së biçikletave do të evitojë edhe parkimin e keq të makinave duke krijuar lehtësi edhe për qarkullimin e autobuzit.

Një propozim mund të jetë edhe kalimi në disa segmente me orare të caktuara që do të lehtësojë kështu transportin publik.

Zv. kryetari – jemi duke i shqyrtuar këto problematika – kemi bërë takime edhe me drejtorinë e policisë së shtetit për të gjetur mundësin e sistemimit të qarkullimit në disa rrugë.

Andi Kadija – a do të ketë linjë transporti publik në zonën e unazës?

Kjo është e vështirë për t'u realizuar sepse linja nuk ka fluks të mjaftueshëm për të pasur mundësi për të mbuluar shërbimin.

4- Shërbimet e ujësjellësit

Furnizimi me ujë të pijshëm, cilësia etj.

Andi Halluni – sa i përket furnizimit me ujë, jemi ndër qytetet që nuk mund të ankojemi as për furnizimin apo cilësinë por duhet të ketë vemëndje në pastrimin e pucetave dhe ujrave të zeza të cilat sidomos gjatë sezonit të rreshjeve krijojnë problem.

5- Qendra shëndetsore

Deputete Emilja Koliqi - Jemi në dijeni për dy projektet me financime të huaja pranë ish konvikteve shkollës veterinare – kur do të fillojë funksionimi i tyre dhe përfundimi i këtyre projekteve që do të krijojnë edhe hapsira për çerdhe dhe kopësht apo qendër shëndetsore.

Zv. kryetari – tek ish konvikti ka përfunduar investimi kemi pasur problem lidhjen e energjisë me OSHEE dhe ka pak ditë që kemi përfunduar negocimin me Oshee për të bërë lidhjen e energjisë dhe në vijim të shpërndahen shtëpit për përfituesit.

Sa i përket shkollës veterinare – është një investim që do të përfundojë brenda verës së vitit tjetër – ku ka pasur edhe një shtesë për investim në ambjentet e jashtme –

Imelda Kraja – qendra do të ketë qendër shëndetsore dhe çerdhe duke krijuar hapsirat e një qendre multifunkionale me bibliotekë dhe ambjente rekreative – do të investohet edhe jashtë godinës.

Erjon Metushi – qendra shëndetsore nr. 1 që ndodhet pranë poliklinikës –Ambulancë Kongresi i Përmetit – nuk ka ambjente dhe ambjenti është me qera nga vetë mjeku.

Mjeku i fëmijëve gjithashtu ka krijuar një ambjent privat. Duhet një ambjent i përshtatshëm

Ambulanca Vasil Shanto po ashtu është private dhe nuk ka mjedise publike.

Sa i përket Shirokës është investuar dhe është marrë dhe bashkia me sistemimin e ambjenteve të kësaj qendre shëndetsore.

Zv. kryetari – duhet të dalim edhe në terren të verifikojmë këto qendra që po diskutohet dhe të gjehet mundësia e ofrimit të ambjenteve nga Bashkia Shkodër.

– sa i përket terreneve sportive apo aktiviteteve sportive a kemi dicka për të shtuar, ndonjë propozim?

Andi Kadija – për banorët e zonës Ndocej, tek shkolla Salo Halili ka dy tre fusha dhe a është e mundur që fëmijët e komunitetit të përdorin këto ambjente për aktivitete sportive. Duke qënë se shkollat janë të mbyllura gjatë mbasdites të gjehet mundësia për të hapur shkollat gjatë mbasdites.

Zv. kryetari – ne jemi duke diskutuar për hapjen e këtyre shkollave ku ka ambjente sportive për banorët e komunitetit përgjatë orareve të masdites si për terrenet e jashtme ashtu edhe për palestrat.

Gerti Shella – Star III : - Ju Falenderoj për këtë degjesë model që zhvillon për konsultimin publik dhe ky është një model që ne duam ta shpërndajmë dhe përçojmë edhe në bashkitë e tjera.

Jemi të kënaqur shumë nga bashkëpunimi me sekretarin e këshillit dhe të gjithë stafin për këtë format konsultimi të hapur , qytetar, serioz e transparent.

Shpresojmë të kemi mundësi ta mbështesim këtë proces dhe ta bëjmë një model kombëtar.

Zv. kryetari – jemi munduar në vite së bashku me këshillin bashkiak që të zbatojmë me seriozitet propozimet e banorëve. Së fundi falenderoj pjesëmarrësit për prezenzen dhe propozimet.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema








BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.1

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1)	FATMIRA	KRAJA	FEMËR	45	SHKODËR	EDUKATORE	-
2)	Enida	Jonaši	Femer	38	shkoder	Ekonomist	-
3)	Blendi	Haraj	Femer	41	SHKODËR	Mësues	ZUA
4)	ESHERRALDA	ZENELE	Femer	36	SHKODËR	Psikologje	-
5)	Gjibran	Selip	femër	33	Shkodër.	Ekonomist	Bashkia Shkodër
6)	Plator	Micela	F	42	Shkodër	Financier	Bashkia Shkodër
7	Arjeta M.	Mikha	F	27	Shkodër	Speshaliste	Bashkia Shkodër
8	Glorye	shllaku	F	32	Shkodër	Mësues	Xuendit Shqipëri
9)	Demis	Fgmi	M	36	SHKODËR	EKONOMIST	PRIVAT
10)	Beser Caudte	Grishle	M	37	Shkodër	Ekonomist	B. Shkodër
11)	Ziblan	Quri	M	57	shkoder	Lushnier	B. Shkodër
12	Alfred	Zuketa	M	56	Shkoder	Turist	B. Shkodër
13	Jano Shkodri	Shkodri	F	44	shkodër	Shkodër	B. Shkodër

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK




BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.1

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Verhet	Bebi. Verhet					
15	Shok Rupa	Shok Rupa					
16	Adrian Roshani	Adrian Roshani					
17	Myniv Sokol	Myniv Sokol					
18	Erziri Haxhiu	Erziri Haxhiu					
19	SHKODËR	SHKODËR	M		SHKODËR	INSPEKTOR	
20	Shkodër Rupa	Shkodër Rupa	M		Shkodër		
21	Blendi Cerri	Blendi Cerri	M	45	SHKODËR	SHOKER	
22	Edmond Belloni	Edmond Belloni	M	43	LAGJIA NR1	JURIST	INSPEKTOR
23	Proletar Roshani	Proletar Roshani	M	51	SHKODËR	SHOKER	
24	Antoni Muri	Antoni Muri	M	41	SHKODËR LAGJIA	Ekonomist	
25	Shkelzen Krasja	Shkelzen Krasja	M	38	Lagja NR1	Zergeri dhe Stoli	
26	Enxhe	Enxhe	F	59	Shkodër k.H.	Drejtues dhe Kuvendi	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.1

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
27	Vildan	Gushita	F	54	Rajoni I.	Juriste	RGJC.
28	Stela	Hoxhi	F	30	Rajoni I	Inspetore	RGJC
29	Gent	Shalla	M	46	TIRANE	Jurist	MPKCP
30	Tea	Pasholli	F	22	TIRANE	Juriste	Infocep.
31	Andi	Hebllemy	M	48	SHKODËR	Jurist	Presnet
32	Ebon	Celiku	M	34	SHKODËR	Po punë	Po punë
33	Enon	Metushi	M	25	SHKODËR	FARMACEUT	Keshillim
34	Melidon	Dervishi	M	28	SHKODËR	Biznesmen	Presnet
35	Argjander	Dushi	M	59	SHKODËR	Po punë	Presnet

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK